



Republika e Kosovës
Republika Kosova/ Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tuzilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

KPK/Nr. 1008/2023
Datë: 22 dhjetor 2023

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 7 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11 të Ligjit Nr.06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe nenit 11 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të Rregullores Nr.02/2021 për Transferimin dhe Avancimin e Prokurorëve të Shtetit, në takimin e mbajtur më datë 22 dhjetor 2023, nxjerr këtë:

VENDIM

- I. Znj. Mimoza Shala, prokurore në Departamentin e Përgjithshëm të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, avancohet në Departamentin për të Mitur të Prokurorisë Themelore në Prishtinë nga data 15 janar 2024.
- II. Obligohet znj. Mimoza Shala që t'i kryej lëndët me kryerës të njohur nga departamenti paraprak. Ndërsa lëndët e llojeve tjera (kryerës të panjohur dhe lëndët e ndryshme) iu shpërndahen prokurorëve të njësive në mënyrë automatike nga SMIL-i.
- III. Znj. Mimoza Shala ka të drejtë në beneficionet që dalin nga ushtrimi i detyrës së prokurorit në Departamentin për të Mitur në Prokurorinë Themelore.
- IV. Obligohet Sekretariati që këtë Vendim ta publikojë në Ueb portalin e sistemit prokurorial të Republikës së Kosovës.
- V. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

Arsyetim

Këshilli Prokurorial i Kosovës në takimin e mbajtur me datë 22 dhjetor 2023 ka shqyrtuar Raportin e Komisionit për Transferimin dhe Avancimin e Prokurorëve të Shtetit, KPK/KATPSH të datës 16 nëntor 2023, ku pas shqyrtimit të të njëjtit raport, Këshilli me shumicë të votave dhe duke u bazuar në legjislacionin në fuqi vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Jetish Maloku
Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës

T'i dërgohet:

- Znj. Mimoza Shala;
- Kryeprokurorit të P. Th. Prishtinë;
- Sekretariatit të KPK-së;
- Dosjes së prokurorëve;
- Arkivimit të KPK-së